



Prishtinë, 18 shtator 2008
Kodi i ZRRE-së: V_125_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Nenin 15.2 pika c), 26.1 dhe kreut 9 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenin 15.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike
3. Nenin 5 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhënë KOSTT Sh.A.
4. Kërkesës për aprovim të Metodologjisë së Tarifave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit të KOSTT SH.A. të datës 31 korrik 2008, **në seancën e mbajtur me date 18 shtator 2008, nxori këtë:**

VENDIM

I. APROVOHET Metodologjia e Tarifave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit të KOSTT SH.A.

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRÉ) me datë 31 korrik 2008 ka pranuar Kërkesës për aprovim të Metodologjisë së Tarifave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit të KOSTT SH.A.
2. ZRRE ka shqyrtuar Metodologjinë në fjalë, dhe pas plotësimit e ka aprovuar atë.
3. Nga data e pranimit të këtij vendimi apo publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, KOSTT-i duhet të publikojë menjëherë në faqen e vet elektronike versionin e aprovuar të Metodologjisë së Tarifave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e nxjerrjes apo data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e aprovimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, kryesues

Nysret Avdiu, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare